Press Release

PUBLIC AFFAIRS SECTION

Ul. Samoilova 21/1000 Skopje || TEL: (02) 310 2000; FAX (02) 310 2499

e-mail: ircskopje@t-home.mk

To: ***Editor in Chief***
Newsroom

Deklaratë e Ambasadës së SHBA

I kemi ndjekur me kujdes dhe dëshpërim konfrontimet politike në dhe jasht ndërtesës të Kuvendit dy ditët e fundit, dhe u bëjmë thirrje të gjitha palëve të ndalojnë çfarëdo veprime provokative. Shprehja e mendimeve të ndryshme në mënyrë të qetë është bazë për një vend të fuqishëm dhe demokratik, ndërsa përdorimi i dhunës nga cilado palë e involvuar, e dëmton sistemin dhe aftësinë e tij për të qeverisur në mënyrë të përgjegjshme. Shtetet e Bashkuara nxisin liderët e të gjitha partive politike dhe mbështetësit e tyre t'u vëndojnë fund konfrontimeve. I ftojmë të sjellen në mënyrë që është në përputhshmëri me ligjin, Kushtetutën dhe rregullat e miratuara të Kuvendit, dhe duke patur parasysh interesat e qytetarëve të cilët i përfaqësojnë.

###